



# AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

## Buletini i Njoftimeve Publike

Nr.41

Datë 29.06.2026

**Agjencia e Prokurimit Publik**

**Blv "Dëshmorët e Kombit"**

**Tel: + 355 4 2277510**

**e-mail: [info@app.gov.al](mailto:info@app.gov.al)**

**<https://www.app.gov.al>**



PDF

2. Të zotërojnë gjuhën Angleze me dëshmi.
3. Të jetë shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar.
4. Të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin e punës për të cilin konkurojnë.
5. Të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale me dashje.
6. Të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.

Kritere të veçanta:

1. Preferohet të ketë njohuri të Ligjit të Arsimit të Lartë.
2. Preferohet të ketë eksperiencë pune në administratë në institucionet e Arsimit të Lartë.

Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për pozicionin e punës për të cilin aplikon.
2. Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe e përditësuar (CV – Curriculum Vitae).
3. Diplomë dhe listë notash për të gjitha ciklet e studimeve universitare (të noteruara). Për diplomat e marra në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet fotokopje e noteruar e certifikatës së njohjes nga strukturat përgjegjëse përkatëse.
4. Dëshmi të njohjes dhe përdorimit të çdo certifikate apo dëshmie kualifikimi që kanë (të noteruar).
5. Dëshmi e zotërimit të gjuhës së huaj (të noteruar).
6. Çertifikatë personale.
7. Çertifikatë e gjendjes familjare.
8. Të paktën një referencë nga punëdhënësi i fundit.
9. Kopje të librezës së punës dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore.
10. Raport i lëshuar nga komisioni mjeko ligjor për aftësi në punë.
11. Raport për kryerjen e kontrollit bazë (Librezë shëndeti).
12. Dokument identifikimi.
13. Dëshmi penaliteti.

Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe me intervista të drejtpërdrejta.

Afati i dorëzimit të dokumentacionit është nga data 29.06.2026 – 13.07.2026

## **UNIVERSITETI “EQREM ÇABEJ”**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë, në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 57, pika 2;

Statutit të Universitetit “Eqrem Çabej”, neni 47, pika 2 dhe neni 56, shpall konkursin për personel akademik me kohë të plotë, për arsye të zhvillimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, për vitin akademik 2026-2027 si më poshtë:

1 (një) personel akademik me kohë të plotë, në fushën e Biologjisë dhe Mjedisit pranë Njesisë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

1. Të ketë përfunduar studimet “Bachelor” me note mesatare jo me pake se 8 (tete) , “Master i Shkencave” dhe “Diplome e integruar”, në sistemin me kohë të plotë, në fushat e Biologjisë, Kimisë, Biologji-Kimisë, Bioteknologjisë, ose diplomë ekuivalente me to (me sistemin e vjetër të studimeve), me notë mesatare të përgjithshme, për te dy programet e studimit jo me pak se 7 (Shtatë).
2. Në rast se i interesuari zotëron një diplomë të marrë në universitete të huaja, kërkohet që të jetë e ekuivalentuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
3. Preferohen kandidatët:
  - a) me titull akademik, gradë shkencore “Doktor” (PHD), ose “Master Ekzekutiv” në fushat e Biologjisë, Kimisë, Biologji-Kimisë, apo Bioteknologjisë,
  - b) që kanë përfunduar programe studimi në Biologji, Kimi, Biologji-Kimi, Bioteknologji,
  - c) njohës të një gjuhe të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), sipas testeve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me përjashtim të atyre që kanë përfunduar në një prej cikleve të studimit në një nga këto gjuhë të huaja.
  - d) me eksperiencë në mësimdhënie universitare.
  - e) me aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
  - f) me aktivitete botues dhe referues, në revista shkencore ose konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare të njohura zyrtarisht.

1 (një) personel akademik me kohë të plotë, në fushën e Kimisë pranë Njesisë Bazë të Shkencave Biologjike, Mjedisore dhe Ushqimit në Fakultetin e Shkencave të Natyrës.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët

1. Të ketë fituar gradën shkencore “Doktor” (PHD), në fushën e kimisë apo të ketë përfunduar studimet “Master Ekzekutiv” ose “Master i Shkencave”, në fushën e Kimisë ose diplomë ekuivalente me to (me sistemin e vjetër të studimeve) në Kimi me notë mesatare të përgjithshme, jo më pak se 8 (tete)..
2. Të ketë përfunduar studimet “Bachelor” në Kimi, në sistemin me kohë të plotë, me notë mesatare të përgjithshme, jo më pak se 8.5 (tetë pike pese). Nota mesatare është kriter skualifikues me përjashtim të kandidatëve që zotërojnë gradën shkencore Dr ose titujt akademik Prof.Asoc.Dr.dhe Prof Dr.
3. Në rast se i interesuari zotëron një diplomë të marrë në universitete të huaja, kërkohet që të jetë e ekuivalentuar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit.
4. Preferohet të ketë përfunduar programe studimi në kimi.
5. Të zotërojë një gjuhë të huaj të Bashkimit Europian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht), sipas testeve të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, me përjashtim të atyre që kanë përfunduar studimet në një nga këto gjuhë të huaja.

6. Të ketë eksperiencë në mësimdhënie univeristare.
7. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në gup.
8. Të ketë aktivitet botues në revista shkencore të njohura zyrtarisht ose material shkencor në konferenca kombëtare e ndërkombëtare.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët që konkurojnë

1. Kërkesë me shkrim;
2. Jetëshkrim sipas formatit standard (europass);
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID).
4. Kopje të diplomës/ve dhe të listës/ave së notave përkatëse (të noteruara). Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të dorëzohet njehsimi nga Ministria e Arsimit dhe e Sportit;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë të notuar);
6. Vërtetim të gjëndjes shëndetësore (Raport mjekësor për aftësitë në punë);
7. Vërtetim i gjëndjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
8. Dokumentacion nga institucioni ku ka punuar që nuk është marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera në jetëshkrimin e tyre;
10. Dëshmi penaliteti.

Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Mosparaqitja e plotë e dokumentave, sjell s'kualifikim të kandidatit.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurimit me dosje dhe intervistës me gojë.

Komisioni ad-hoc do të vlerësojë dosjet e kandidatëve. Konkursi do të zhvillohet në Rektoratin e UGJ-së. Dokumentat e mësipërm të noterizuar, të 3 (tre) muajve të fundit dhe dorëzohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Universitetin "Eqrem Çabej", të shoqëruara me inventar.

Afati i fundit i pritjes së aplikimeve është brenda 5 ditë pune nga data e publikimit të njoftimit.

## **UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË**

### **Njoftim për vend të lirë pune**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin dhe Rregulloren e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë si dhe në Urdhrin e Rektorit të UMT-së nr. 55, datë 25.06.2026 "Për miratimin e kriterëve dhe fillimin e procedurës për pozicionin e punës personel ndihmës akademik "Laborante Mësimore", në Departamentin e Sëmundjeve Infektive, Sëmundjeve të Lëkurës, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë", shpallet konkursi për pozicionin e punës, personel ndihmës akademik "Laborante